



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 117
Prishtinë, më 8 korrik 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 8 KORRIK 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorin e Shtetit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009,
11. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009,
12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik,
13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit,
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e druve”, në Prishtinë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Donika Kadaj-Bujupi, Driton Tali, Fatmir Rexhepi, Riza Smaka, Slobodan Petroviç, Rexhep Hoti, Sabri Hamiti, Melihate Tërmkolli, Bahri Hyseni, Gani Geci, kryeministri Hashim Thaçi dhe zv/kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 25 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 25 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Nerxhivane Dauti**, parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me fazën e përgatitjes së Projektligjit për ndërtimin, në Kuvend.

Ministri **Yagcilar**, iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, parashtroi pyetje për ministrin, Enver Hoxhaj, lidhur me kohën e rritjes së pagave për mësimdhënësit dhe sa do të jetë ajo rritje?

Në mungesë të ministrit Hoxhaj, kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Ismajl Kurteshi**, parashtroi pyetje për ministrin, Lutfi Zharku, lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për importimin e naftës e cila përmban më shumë se 10 % sulfur.

Ministri **Zharku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kurteshi.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me hapat konkret të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, në mënyrë që ndotësit më të mëdhenj në Kosovë, siç janë, Feronikeli, KEK-u etj, t'i vendosin filtrat dhe masat tjera të ministrisë për zbutjen e problemeve mjedisore.

Ministri **Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kurteshi.

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, apo zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi, lidhur me atë se kur do të fillojnë punën gjashtë grupet punuese për zbatimin e strategjisë për veriun.

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Ministri **Haki Demolli**, tha se Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës është rezultat i punës së vazhdueshme të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore.

Në vijim, tha se ky projektligj siguron krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur për administrim të gjykatave dhe siguron gjithashtu që ky sistem të jetë gjithëpërfshirës, pastaj përcakton kompetencat e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, nominimin dhe emërimin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, trajnimin e gjyqtarëve etj.

Projektligji, të cilin po e shqyrtojmë, paraqet një hallkë shumë të rëndësishme në reformimin e sistemit gjyqësor dhe të gjykatave, në pajtim me realitetin e krijuar në Republikën e Kosovës, do ta rriste efikasitetin në sistemin gjyqësor dhe do të zëvendësohej legjislacioni i UNNMIK-ut nga kjo fushë, i cili më nuk është kompatibil me realitetin e ri tek ne, tha ai.

Në fund, ministri Demolli ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Teuta Hadri, Naim Rustemi, Sanije Aliaj, Arsim Bajrami, Riza Smaka, Driton Tali, Rexhep Hoti, Hydajet Hyseni, Naser Rugova, Rustem Mustafa, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ministri **Haki Demolli**, tha se ky projektligj paraqet njërin nga projektligjet shumë të rëndësishme për kompletimin e infrastrukturës ligjore nga kjo fushë, në përpilimin e të cilit kanë marrë pjesë edhe ekspertë ligjorë ndërkombëtarë.

Në vijim, tha se ky projektligj Këshillin Prokurorial të Kosovës e përcakton si organ i cili i administron prokuroritë, politikat, kompetencat, përgjegjësitë dhe strategjitë e Këshillit Prokurorial, procedurat disiplinore, trajnimin e prokurorëve etj.

Miratimi i këtij projektligji do të ndikojë në luftimin më efikas të krimit, në rritjen e besueshmërisë së qytetarit në prokuroritë e Republikës së Kosovës, konstatoi ai.

Ministri lidhur me këtë projektligj theksoi se miratimi i tij do të kishte efekte pozitive edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2010.

Në fund, ministri Demolli ftoi deputetët të miratojnë, në parim, të Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selvije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Adem Hajdaraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Hydajet Hyseni dhe ministri Haki Demolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,
Kundër-----0,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prokurorin e Shtetit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për Prokurorin e Shtetit.

Ministri **Haki Demolli** tha se me këtë projektligj do të kompletohet infrastruktura ligjore e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Në përpilimin e tij kanë marrë pjesë edhe ekspertë ndërkombëtarë të angazhuar nga Ministria e Drejtësisë.

Në vijim, tha se ky projektligj përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë rreth organizimit dhe funksionimit të Prokurorit të Shtetit.

Miratimi i këtij Projektligji do të garantonte funksionimin e sistemit prokurorial të pavarur në Kosovë.

Ministri lidhur me këtë projektligj theksoi se miratimi i tij do të kishte efekte pozitive edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2010.

Në fund, ministri Demolli ftoi deputetët që ta miratim, në parim, të Projektligjit për Prokurorin e Shtetit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Prokurorin e Shtetit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Branislav Grbiç, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Prokurorin e Shtetit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër-----0,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore.

8. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar Projekt-Kodin e drejtësisë për të mitur dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti **Bahri Hyseni**, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, e arsyetoi Raportin me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet nr. 1, 2 (a), 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 (a) dhe amendamentin nr. 26, të propozuara në Projekt-Kodin e drejtësisë për të mitur.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projekt-Kodit të drejtësisë për të mitur, në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Kodin e drejtësisë për të mitur.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Kryesuesi e hodhi në votim amendamentin e vetëm, të propozuar nga komisioni funksional.

Kuvendi miratoi amendamentin nr.1, të propozuar në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike tha se Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputeti **Naser Rugova**, në emër të komisioni funksional, arsyetoi raportin me rekomandime.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selville Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Branislav Grbiç, si dhe deputetët: Drita Kadriu, Abdyl Ymeri, Nurishahe Hulaj, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

11. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009

Kryesuesi tha se Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për miratim.

Në emër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, për këtë pikë të rendit të ditës foli Ahmet Shala.

Ministri **Ahmet Shala**, tha se auditimi i brendshëm është rezultat i rritjes së qeverisjes së mirë, kurse përpilimi i këtij raporti është rezultat i të gjitha organeve të auditimit.

Ligji për auditimin e brendshëm ka mundësuar edhe nxjerrjen e disa udhëzimeve administrative, tha ai.

Në vijim tha se me qëllim të rritjes së performancës së punës së auditorëve, në shtator të vitit 2009, kemi filluar projektin për trajnimin e auditorëve të brendshëm, ku janë të përfshirë rreth 60 auditorë, nga tërë Kosova.

Në fund ai konstatoi se në të ardhmen nevojitet plotësimi i njësive të auditimit me auditorë të rinj si dhe rritja e kapaciteteve humane dhe profesionale të këtyre njësive, dhe ftoi deputetët për miratim të këtij raporti.

Deputeti **Haki Shatri**, në emër të Komisioni funksional, tha se në këtë raport, të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditorin e Brendshëm, shihet se ka rritje të aktiviteteve dhe të detyrave shtesë, të auditorëve, nga kjo fushë. Në vijim tha se brengos fakti se disa organizata buxhetore, kësaj fushe nuk i kanë kushtuar rëndësinë e duhur. Ka raste kur ndonjë raport i kryer nga Auditori i Përgjithshëm nuk përputhet me të dhënat e raportit të cilin po e shqyrtojmë sot, konstatoi ai.

Në fund ai ftoi deputetët për miratim të këtij raporti me rekomandimet e Komisionit funksional.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës, për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anita Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Berim Ramosaj, Sanije Aliaj, Driton Tali dhe Gjylnaze Sylja, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----1,
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Kryesuesi, në fillim, tha se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Kuvendit i ka rekomanduar, për miratim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim - vendim dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, ndërsa në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër-----14,
Abstenime-----7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

I. Anëtarë të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik emërohen.

1. Safet Hoxha, kryetar;
2. Iliaz Duli, anëtar,
3. Silvana Nikolqeviq, anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.

13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

Kryesuesi, në fillim, tha se Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim.

Deputeti **Naser Rugova**, në emër të Komisioni FunkSIONAL, arsyetoi raportin me rekomandimet.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

I. Anëtarë të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit emërohen.

1. Behxhet Mustafa;
2. Sylejman Berisha;
3. Islam Fejza;
4. Kemail Bislimi;
5. Nystrete Doda-Gashi;
6. Tush Markaj dhe
7. Luan Shllaku.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit.

14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e druve”, në Prishtinë

Kryesuesi, në fillim, tha se Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Propozim – vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale “Lama e druve”, në Prishtinë, dhe Kuvendit i ka rekomanduar, për miratim.

Deputeti **Naser Rugova**, në emër të Komisioni funksional, arsyetoi raportin me rekomandime.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij propozim-vendimi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të shpallur zonë të veçantë ngastrën kadastrale 3114-1 deri 3125-2 me sipërfaqe prej 90736 m² të vendi i quajtur "Lama e druve", në Prishtinë, e cila është pronë e IMN "Kosova" nr. 03/3976/DO-2434.

Në fund të mbledhjes plenare, deputetëve të Kuvendit iu drejtua me një fjalë rasti kryeministri i Republikës së Kosovës, **Hashim Thaçi**, me rastin e nxjerrjes së Rezolutës së Parlamentit Evropian për Kosovën.

Ai tha se Rezoluta e Parlamentit Evropian për Kosovën, e nxjerrë sot, i jep një mbështetje të re sovranitetit dhe integritetit të shtetit të Kosovës. Në vijim, tha se çmojmë konstatimin se integrimi i shteteve të Ballkanit në Bashkësinë Evropiane duhet të përfshijë edhe Kosovën. Me kënaqësi presim gjithashtu që Komisioni Evropian ta riformulojë Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, tha ai.

Në vazhdim, ai theksoi se Parlamenti Evropian vlerëson daljen e fundit në zgjedhje të popullatës serbe, të organizuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, dhe veprimet e institucioneve të Kosovës për funksionimin e komunave të reja .

Rezoluta vlerëson po ashtu rolin e medias dhe të shoqërisë civile në procesin ligjvënës në Republikën e Kosovës, theksoi kryeministri.

Në fund, ai ftoi deputetët të japin kontributin e tyre, pa dallime partiake, për integrimin e Republikës së Kosovës në strukturat euroatlantike.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale